

REMITANCAT NË KOSOVË

Shuma të mëdha, diskutim i vogël

"Raport me opinionet e diasporës - dërguesve të remitancave në Kosovë"

Mars, 2022



Të drejtat e autorit © 2022. GERMIN

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përveç citimeve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, fotokopjues, ose tjetër, pa lejen paraprake të autorit.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës GERMIN.

Lista e Akronimeve

BQK - Banka Qendrore e Kosovës

Tm1 - Tre mujori i parë i vitit

Tm2 - Tre mujori i dytë i vitit

Tm3 - Tre mujori i tretë i vitit

ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës

AFP- Anketa e Fuqisë Punëtore

Lista e tabelave

Tabela nr.1 Të dhënat demografike nga pyetësi

Tabela nr.2 A keni dërguar para në vendin amë në pesë vitet e fundit?

Tabela nr.3 Infografikë mbi Remitancat në Kosovë, shuma totale e remitancave nga viti 2011 deri 2021.

Tabela nr.4 Nëse po, cili është kanali kryesor i dërgimit?

Tabela nr.5 Cili vlerësoni se është kanali më i sigurtë i dërgesave?

Tabela nr.6 A janë të larta kostot e transferove përmes bankave dhe agjencive për transfere të parave?

Tabela nr.7 A keni informacion për kompanitë që bëjnë transfer të parave me kosto shumë të ulëta (p.sh Revolut, Wise, Curve, etj).

Tabela nr.8 Si e vlerësoni se ku shpenzohen më shumë remitancat nga pranuesit në Kosovë? (Mund të selektoni disa përgjigje).

Tabela nr.9 Ku vlerësoni se duhet të shpenzohen remitancat në Kosovë? (Selekto një përgjigje).

Tabela nr.10 Nëse nuk dërgoni para në Kosovë, a e vlerësoni se do të përkeqësohej situata financiare e familjes, miqve apo të afërmve?

Tabela nr. 11 Si informoheni në lidhje me shërbimet e transferove ose shërbimet financiare në Kosovë?

Tabela nr.12 A pajtoheni me konstatimin e mëposhtëm: Remitancat i kanë pasivizuar një pjesë të madhe të popullsisë, duke bërë që ata të mos jenë aktiv në tregun e punës dhe të mos shikojnë mundësitë për punësim?

Tabela nr.13 A vlerësoni se duhet të ketë programe për edukim financiar për pranuesit e remitancave, në mënyrë që ata të shpenzojnë ato në sektorë produktiv?

Tabela nr.14 Sa është i vlefshëm diskutimi mbi aspekte të ndryshme të Remitancave në Kosovë?

Përmbajtja	
Hyrje	1
Metodologjia	1
Të gjeturat nga Hulumtimi	3
Dërgimi i parave në vendin amë	3
Kanalet e dërgimit të mjeteve financiare	4
Kanalet më të sigurta të dërgimit të mjeteve monetare	5
Kostot e transfereve	6
Transferi i parave me kosto më të ulët	7
Shpenzimi i remitancave në Kosovë	8
Ku do të duhej të shpenzohen remitancat	9
Situata financiare e Kosovës pa remitanca	10
Informimi për transferet dhe shërbimet financiare	11
Ndikimi i remitancave në joaktivitetin në treg të punës	12
Shpenzimi i remitancave në sektorë produktiv	13
Diskutimi i remitancave në Kosovë	14
Konkluzionet	15
Rekomandimet	16
Rekomandime për pjesëtar të diasporës	16
Rekomandime për personat të cilët pranojnë remitancat	17
Rekomandime për institucionet qeveritare	17
Rekomandime për Organizata vendore dhe ndërkombëtare	18
Bibliografia	19

Hyrje

Diaspora e Kosovës vlerësohet të jetë e madhe në krahasim me numrin total të qytetarëve të Kosovës. Numrat nuk janë të saktë, por në total diaspora e Kosovës kalon diku mbi 900.000 persona. Shumica e kosovarëve jashtë vendit jetojnë në Gjermani (39%), Zvicër (23%), Austri (7%), Itali (7%), Suedi (5%) Mbretëri të Bashkuar (5%), Shtetet e Bashkuara të Amerikës (3.5%), Kroaci, Francë, Kanada (nga 2% secila).¹ Marrë parasysh numrin e madh të diasporës shqiptare, është e natyrshme që edhe remitancat të jenë shumë të larta. Remitancat në Kosovë paraqesin kategorinë më të lartë të të hyrave dytësore, kjo bazuar edhe në numrin e madh të mërgimtarëve të cilët jetojnë në shtete të ndryshme por që nuk kanë shkëputur kontaktet me vendin amë. Në bazë të të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore, trajektorja e remitancave tregon një rritje të vazhdueshme ndër vite. Në vitin 2021 janë pranuar më shumë se 1 miliard euro ndërsa në vitin 2011 ishin më pak se 500 milion euro. Ngjashëm me koncentrimin e pjesëtarëve të diasporës sipas shteteve të ndryshme është edhe përqindja e remitancave nga këto shtete, ku pjesa më e madhe e remitancave vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, pasuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Austria, Italia dhe Franca.

Remitancat përbëjnë një prej burimeve më të mëdha të diasporës së Kosovës. Dërgesat e remitancave në Kosovë paraqesin një ndër burimet kryesore të financimit të konsumit të ekonomive familjare. Si një burim që siguron gjendje stabile sociale, remitancat zvogëlojnë ngarkesën ndaj buxhetit shtetëror. Sidoqoftë, sfiduese për ekonominë e Kosovës vazhdon të mbetet kanalizimi i dërgesave nëpërmjet rrugëve formale, sidomos bankave. Natyra e remitancave mund të jetë e ndryshme, si: **a) Remitancat individuale**, kur dërgohen për ekonomi familjare; **b) Remitancat kolektive**, kur grumbullohen dhe dërgohen nga një komunitet i caktuar në shtetin rezident në vendin e origjinës; **c) Filantropia**, kur anëtarët e diasporës bëjnë donacione individuale për në vendin e origjinës për një kauzë apo program specifik e cila është në të mirë sociale.

Me këtë kontekst, ne kemi realizuar këtë hulumtim i cili ka për qëllim të ofrojë një pasqyrë të opinionëve të pjesëtarëve të diasporës së Kosovës mbi sfidat dhe mundësitë për ta bërë tregun e dërgesave të parave më efikas për të rritur ndikimin e remitancave në ekonominë vendase, e sidomos kapërcimit të sfidave të shfaqura nga pandemia.


Metodologjia

Pjesa më e madhe e këtij raporti shtjellon të dhënat nga pyetësi i cili është bërë me pjesëtarë të diasporës. Pyetësi është krijuar në platformën SurveyMonkey, ndërsa është ndarë në rrjetet sociale të organizatës Germin (Facebook, Instagram, LinkedIn), në periudhën janar-mars 2022. Rrjedhimisht, pjesëmarrja në këtë pyetësor ishte rastësore, nga personat të cilët ndjekin rrjetet sociale të organizatës Germin. Pyetësi kishte gjithsej 17 pyetje, prej të cilave 5 ishin pyetje demografike.

¹ *Instituti Riinvest, Diaspora dhe politikat e Migracionit, Dhjetor 2007, Prishtinë*
<https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476702625.pdf>

Pyetjet kanë qenë të mbyllura me mundësi të përzgjedhjes së një opsioni, përjashtim të dy pyetjeve ku kishte mundësi të zgjedhjes më shumë se të një opsioni. Në total janë përgjigjur 102 persona, prej të cilëve 62.75% ishin burra/djem ndërsa 37.25% ishin gra/vajza. Mosha e personave të cilët morën pjesë në pyetësor përbënte pjesën më të madhe 27-35 vjeç me 33.33%, duke pasuar me moshën 36-45 vjeç me 28.14%, 18-26 vjeç me 18.63%, 46-55 vjeç me 17.65% dhe mbi 56 vjeç me 1.96%. Sa i përket vendbanimit aktual 24.23% e pjesëmarrësve jetojnë në Gjermani, 23.23% në Austri, 12,12% në Belgjikë, 11.11% në Zvicër dhe 32.32% në vende të tjera. Gjithashtu, raporti përmban edhe pjesën e hulumtimit dhe analizës së statistikave nga të dhënat në internet, si raportet e Bankës Qendrore, Bankës Botërore dhe Agjencie Financiare. Në përgjithësi ky raport është bërë duke përdorur metodën kuantitative - duke llogaritur të dhënat e dalura nga pyetësori por edhe mbledhjen e të dhënave mbi remitancat ndër vite; si dhe metodën kualitative- duke analizuar dhe shpjeguar qëndrimet e pjesëmarrësve në pyetësor dhe interpretimin e të dhënave nga raportet e ndryshme të qasme dhe të besueshme.

Tabela nr.1 Të dhënat demografike nga pyetësori




Të gjeturat nga Hulumtimi

Në muajin janar të këtij viti, Germin ka publikuar një pyetësor në rrjete sociale i cili kishte për qëllim të paraqiste një pasqyrë rreth remitançave konkretisht kanalet e dërgimit në Kosovë nga anëtarë të diasporës shqiptare të cilët jetojnë në shtete të ndryshme në të gjithë botën. Pyetjet e këtij pyetësi kryesisht lidheshin me dërgimin e mjeteve financiare në vendin amë, besimin në institucionet financiare, tarifat e transferit, ndikimin pozitiv apo negativ të remitançave në treg të punës, investimet e remitançave etj. Në vijim të këtij raporti janë të shtjelluara pyetjet e pyetësorit dhe qëndrimet e personave të cilët morën pjesë në këtë hulumtim, të kombinuara me statistika nga hulumtimi në internet, me theks të veçantë në raportet e Bankës Qendrore të Kosovës në lidhje me remitançat.

Dërgimi i parave në vendin amë

Remitançat në Kosovë paraqesin kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore nga jashtë. Viti 2021 shënon numrin më të lartë të remitançave që nga paslufta. Në raportin e publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës për tremujorin e tretë (T3) të vitit 2021 shihet se niveli i remitançave ishte 306.9 milion euro. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 janë dërguar 17.1 %, apo 163 milion euro më shumë. Ndërsa në bazë të TM1, TM2, dhe TM3 shuma totale arrin në mbi 1 miliard euro remitanca për vitin 2021.² Në pyetësorin e realizuar nga Germin, në pyetjen se “A keni dërguar para në vendin amë në pesë vitet e fundit?” 89.11% të pjesëmarrësve janë përgjigjur me “PO” ndërsa 10.89 % janë përgjigjur me “JO”.

Tabela nr.2 A keni dërguar para në vendin amë në pesë vitet e fundit?




² Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr.36, Tremujori III/2021 https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/02/BQK_VT_TM3-2021.pdf

Tabela nr.3. Infografikë mbi Remitancat në Kosovë, shuma totale e remitancave nga viti 2011 deri 2021.

REMITANCAT NË KOSOVË

Shuma totale e remitancave nga viti 2011 deri 2021




Kanalet e dërgimit të mjeteve financiare

Dërgimi i mjeteve financiare nga diaspora në vendin amë bëhet duke përdorur kanale të ndryshme të transferit qoftë përmes bankave, agjencie për transfer të shpejtë të parave, aplikacioneve mobile, apo edhe dërgesave përmes familjarëve, miqve apo gjatë vizitave personale. Në bazë të të dhënave nga raporti i Bankës Qendrore, gjysma e remitancave (50.1 %) kanë ardhur përmes agjencie për transferim të mjeteve. Dërgimi përmes agjencie për transferim të mjeteve për TM3 2021 ka shënuar një rënie prej 20.6 %. Remitancat përmes bankave, në anën tjetër, shënuan një rritje prej 31.1 % dhe tani përbëjnë 18.0 % të të gjitha remitancave të pranuar për të njejtën periudhë kohore.³

E njëjta është vërtetuar edhe me anë të pyetësorit të realizuar nga Germin, ku në pyetjen se “Nëse keni dërguar para në vendin amë në pesë vitet e fundit, cili ka qenë kanali kryesor i dërgimit?” 44.55% e pjesëmarrësve në pyetësor deklaruan se kanë përdorur agjencitë për transfer të shpejtë të parave, 30.69% përmes familjarëve, miqve, apo gjatë udhëtimit personal, 16.83% përmes bankave, ndërsa përqindja më e ulët me 7.92% ishte përmes aplikacioneve mobile.

³ Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr.36, Tremujori III/2021
https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/02/BQK_VT_TM3-2021.pdf


Tabela nr.4 Nëse po, cili është kanali kryesor i dërgimit?



Kanalet më të sigurta të dërgimit të mjeteve monetare

Edhe pse pothuajse gjysma e pjesëmarrësve në pyetësor kanalin kryesor të dërgimit kishin agjencitë për transfer të shpejtë të parave, jo të gjithë i vlerësuat si më të besueshmet. Nga 44.55% të respondentëve që pohuan se e përdorin këtë kanal si kryesorin për dërgim të parave, përqindja pësoi rënie në 27.72% tek dërgimi i sigurt. Në anën tjetër, edhe pse vetëm 16.83% e respondentëve pohuan se i përdorin bankat si kanal kryesor të dërgimit, kjo përqindje u rrit në 50.50% sa i përket sigurisë. Rënie të përqindjeve tek siguria e dërgesave kishte edhe tek aplikacionet mobile 5.94% por edhe format e tjera si dërgesa përmes familjarëve, miqve apo gjatë udhëtimit personal me 15.84%.

Tabela nr.5. Cili vlerësoni se është kanali më i sigurtë i dërgesave?




Kostot e transfereve

Kostot e transfereve për diasporën në vendin amë nuk janë aspak të lira, qoftë kjo për shuma të vogla apo edhe për shuma të mëdha. Ato variojnë në kohë të ndryshme por edhe nga kanali i dërgimit të parave. Gjithashtu një rol të madh luan edhe këmbimi valutor për shtetet të cilat nuk kanë primare valutën euro. Agjencitë për transfer të parave zakonisht kanë komision 6 euro për shumën 0-100 euro (+ këmbimi valutor nëse është i aplikueshëm); 15 euro për vlerat 300.00 - 500.00 euro (+ këmbimi valutor nëse është i aplikueshëm).⁴ Nëse i referohemi mesatares së agjencive për transfer në bazë të “Bankës Botërore – Çmimit të Remitancave,” mesatarja e koston për dërgim të shumës 140 euro nga Gjermania është 7.53 euro. Ndërsa nëse analizohen ndaras, kostoja më e ulët është 3.90 euro dhe më e larta 7.53 euro.⁵ Ndërsa për shumën e njëjtë të dërguar nga Zvicra mesatarja e koston për transfer është 10.32 franga.⁶

Si pjesë e pyetësorit në pyetjen se “A janë të larta kostot e transfereve përmes bankave dhe agjencive për transfer të parave?” shumica e pjesëmarrësve vlerësuan se janë shumë të larta ose mesatarisht të larta. Konkretisht 39.60% prej tyre deklaruan se janë shumë të larta, 38.61% që janë mesatarisht të larta, ndërsa se nuk janë të larta u deklaruan 18.81% e tyre. 2.87% nuk e dinin se sa është kostoja e transfereve përmes bankave dhe agjencive për transfer të parave.

Tabela nr.6 A janë të larta kostot e transfereve përmes bankave dhe agjencive për transfere të parave?



⁴ Unioni Financiar Prishtinë. Tarifas e Dërgesave nga Kosova. <https://ufp-ks.com/tarifas/>.

⁵ Banka Botërore. Dërgimi i parave nga Gjermania në Kosovë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en/corridor/Germany/Kosovo>. Qasur më: Janar 2022.


⁶ Banka Botërore. Dërgimi i parave nga Zvicra në Kosovë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en/corridor/Switzerland/Kosovo>. Qasur më: Janar 2022.

Transferi i parave me kosto më të ulët

Me zhvillimin e teknologjisë dhe përdorimin në masë të madhe të telefonave të mençur, kompani të ndryshme kanë krijuar aplikacione mobile për transfer të parave. Përdorimi i tyre ka lehtësuar dërgimin e parave jashtë vendit në kohë të shpejt por edhe me kosto më të lirë. Për shembull, nëse i referohemi aplikacionit ndërkombëtar Wise, për dërgim të shumës 140 euro nga Gjermania, kosto e dërgimit nga debit ose kredit kartela kushton 0.98 euro dhe arrin brenda një ore. Gjithashtu mund të përdoret edhe transferi më i ulët në vlerë prej 0.41 euro ku shuma arrin brenda 24 orëve. Ndërsa për dërgim nga Zvicra për shumën 140 franga, me transfer bankar kosto është 1.8 franga si dhe shtesë llogaritet konvertimi, ndërsa shuma arrin brenda 6 orëve.

Si pjesë e pyetësorit në pyetjen se “A keni informacion për kompanitë që bëjnë transfer të parave në kosto shumë të ulëta (p.sh Revolut, Wise, Curve, etj)?” shumica dërmuese e pjesëmarrësve nuk kishin informacion (62.38%), pjesa tjetër kishin informacion por nuk i përdorin (19.80%), ndërsa vetëm 17.82% i përdorin mundësitë e këtyre kompanive për transfer.

Tabela nr.7 A keni informacion për kompanitë që bëjnë transfer të parave me kosto shumë të ulëta (p.sh Revolut, Wise, Curve, etj).




Shpenzimi i remitancave në Kosovë

Marrë parasysh që remitancat ndër vite kanë pasur një rritje të madhe, edhe shpenzimi i tyre është kanalizuar në forma dhe qëllime të ndryshme. Natyrisht se shpenzimi i remitancave varet nga faktorë, rrethana, dhe periudha të ndryshme kohore. Si rrjedhojë e ballafaqimit me pandeminë Covid-19 shumë qytetarë në Kosovë janë ballafaquar me humbje të vendit të punës, mbyllje të bizneseve të vogla, dëmtim të bizneseve të mesme e të mëdha e përkeqësim të gjendjes shëndetësore. Padyshim që remitancat ishin një ndër ndihmesat më të mëdha për shumë ekonomi familjare të cilat ndikuan edhe në ekonominë vendore.

Në pyetjen se si e vlerësoni ku shpenzohen më shumë remitancat nga pranuesit në Kosovë, e që mund të zgjedhnin më shumë se një opsion, 84.16% e pjesëmarrësve vlerësuan se pjesa më e madhe shpenzohet në konsum të produkteve ushqimore dhe veshmbathje. Pasuar me kujdesin shëndetësor me 62.38%, investim në patundshmëri (shtëpi, banesa, troje, etj) me 45.54%, investim në edukim 26.73%, blerje të makinave dhe produkteve teknologjike (telefon, kompjuter, etj) 24.75%, pagesa të qirave 18.81%, investim në hapje të bizneseve të reja 16.83%, dhe kategori të tjera 4.95%.


Tabela nr.8 Si e vlerësoni se ku shpenzohen më shumë remitancat nga pranuesit në Kosovë? (Mund të selektoni disa përgjigje).



Ku do të duhej të shpenzohen remitancat

Se ku investohen remitancat dhe ku do të duhej të investoheshin padyshim që ka dallime thelbësore, por përsëri edhe kjo varet nga rrethanat dhe faktorë të ndryshëm me të cilat ballafaqohen ekonomitë familjare. Nëse do të kishte një stabilitet ekonomik më të qëndrueshëm në vend dhe shkalla e punësimit të ishte më e lartë se sa qëndron aktualisht, remitancat nuk do kishin nevojë të shfrytëzoheshin për konsum të produkteve ushqimore dhe veshmbathje por të koncentroheshin në masë më të madhe në investime në edukim/shkollim të fëmijëve apo investime në hapje të bizneseve të reja, të cilat do të gjeneronin të ardhura më të mëdha dhe rritje të vetëpunësimit si dhe të punësimit. Edhe në përgjigjet e pjesëmarrësve në pyetësor vërehet dukshëm dallimi në mes të qëndrimeve se ku investohen remitancat dhe ku vlerësojnë në të vërtetë se duhet të shpenzohen. Pjesëmarrësit vlerësuan se më së shumti duhet të investohet në hapje të bizneseve të reja me 36.00%, duke pasuar me investimet në edukim me 33.00%, kujdes shëndetësor 16.00%, konsum të produkteve ushqimore dhe veshmbathje 7.00%, blerje të makinave dhe produkteve teknologjike (telefon, kompjuter) 2%, pagesa të qirave dhe investime në patundshmëri (shtëpi, banesa, troje, etj) me nga 1% secila, dhe të tjera me 4%.


Tabela nr.9 Ku vlerësoni se duhet të shpenzohen remitancat në Kosovë? (Selektonjë përgjigje).



Situata financiare e Kosovës pa remitanca

Remitancat përbëjnë një pjesë shumë të rëndësishme të të hyrave dytësore në vend. Ato përbëjnë 90% të të ardhurave familjare të marrësve, ku rreth 1/3 e familjeve i përdorin ato për shpenzimet bazë (ushqime dhe ilaçe), ndërsa rreth 41% e marrësve kursejnë një pjesë të dërgesave. Rrjedhimisht, mungesa e tyre do të vërehet shumë në përgjithësi, por sidomos tek ekonomitë familjare të cilat nuk kanë të ardhura primare nga ndonjë burim tjetër. Edhe 35.64% e pjesëmarrësve në pyetësor vlerësuan se nëse nuk dërgojnë para në Kosovë, do të përkeqësohej shumë situata financiare e familjes, miqve apo të afërmeve. Se do të përkeqësohej deri diku e vlerësuan 48.51% e pjesëmarrësve, ndërsa se nuk do të përkeqësohej vetëm 15.84%.



Tabela nr.10 Nëse nuk dërgoni para në Kosovë, a e vlerësoni se do të përkeqësohej situata financiare e familjes, miqve apo të afërmeve?



Informimi për transferet dhe shërbimet financiare

Përdorimi i madh i teknologjisë ka rritur edhe mundësitë për manipulim të madh të qytetarëve me keqinformim të qëllimshëm ose jo. Për këtë është shumë me rëndësi që informatat gjithmonë të merren nga burime dhe institucione të besueshme dhe kredibile. Në bazë të të dhënave nga pyetëtori, pjesëmarrësit më shumë informohen në lidhje me shërbimet e transferëve ose shërbimet financiare në Kosovë nga të afërmit (30.69%), në rrjete sociale (23.76%), nga mediat (17.82%), nga faqet e bankave (13.86%), kontakti direkt me institucionet (9.90%), dhe forma të tjera (3.96%).

Tabela nr. 11 Si informoheni në lidhje me shërbimet e transferëve ose shërbimet financiare në Kosovë?




Ndikimi i remitancave në joaktivitetin në treg të punës

Papunësia dhe joaktiviteti në Kosovë vazhdojnë të jenë shqetësuese. Në bazë të statistikave të fundit të publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, sipas tremujorit të parë të AFP-së 2021 në Kosovë ka pasur 124,657 persona të moshës 15-64 vjeç, që ishin të papunë, 83,141 nga të cilët ishin burra/djem dhe 41,516 gra/vajza. Shkalla e papunësisë ishte 25.8%. Shkalla më e lartë ishte tek gratë/vajzat me 29.7%, ndërsa te burrat/djemtë ishte 24.2%. Edhe më shqetësuese është joaktiviteti i popullsisë, të cilët nuk janë as të punësuar e as në kërkim të punës. Në TM1 2021, 77.3% e grave/vajzave ishin jo aktive në krahasim me 43.5% e burrave/djemve. Nëse i krahasojmë këto të dhëna me tremujorin paraprak të AFP-së (TM4-2020) në Kosovë, kemi rritje të shkallës së joaktivitetit me 1.9%. Kjo rritje te burrat/djemtë ishte 2.7% përderisa te gratë/vajzat kjo rritje është 1.1%.⁷

Edhe pse joaktiviteti i popullsisë në moshë pune nuk mund të ndërlidhet direkt me dërgimin e remitancave, ato mund të kenë një rol sado të vogël. Për të parë qëndrimet e diasporës shqiptare në lidhje me këtë, si pjesë e pyetësorit u parashtrua pyetja se “A pajtoheni me konstatimin e mëposhtëm: Remitancat i kanë pasivizuar një pjesë të madhe të popullsisë, duke bërë që ata të mos jenë aktiv në tregun e punës dhe të mos shikojnë mundësitë për punësim?” 29.70% e pjesëmarrësve u pajtuan me konstatimin, 44.55% u pajtuan deri diku, dhe 25.74% nuk u pajtuan.

Tabela nr.12 A pajtoheni me konstatimin e mëposhtëm: Remitancat i kanë pasivizuar një pjesë të madhe të popullsisë, duke bërë që ata të mos jenë aktiv në tregun e punës dhe të mos shikojnë mundësitë për punësim?



⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2021 2021 <https://ask.rks-gov.net/media/6354/afp-tm1-2021.pdf>

Shpenzimi i remitancave në sektorë produktiv

Edukimi joformal me anë të programeve të ndryshme për investim të duhur dhe përfitues për qytetarë të cilën jetojnë në Kosovë dhe pranojnë remitanca nga diaspora, do të kishte ndikim në menaxhim më të mirë dhe rritje të ekonomisë vendore në mënyrë konstante. Se duhet të ketë edukim financiar për pranuesit e remitancave e mendojnë edhe 82.18% e pjesëmarrësve në pyetësor, ndërsa se nuk ka nevojë për programe të tilla e vlerësuan 17.83% e pjesëmarrësve.

Tabela nr.13 A vlerësoni se duhet të ketë programe për edukim financiar për pranuesit e remitancave, në mënyrë që ata të shpenzojnë ato në sektorë produktiv?

82.18%

Po, duhet të ketë

17.82%


Jo, nuk ka nevojë



Diskutimi mbi remitancat në Kosovë

Kontributi i diasporës dhe mbajtja e kontakteve me vendin amë diskutohet deri diku në vend, por në krahasim me shumën e madhe të të hyrave në vend nga diaspora, ky diskutim mbetet i zbehtë, sidomos nga përfaqësues të institucioneve shtetërore. Përveç të hyrave, nuk kemi as intervenime direkte në stabilitet ekonomik e rritje të punësimit dhe zbehje të joaktivitetit në treg të punës. Gjithashtu, ka mungesë të theksuar të hulumtimeve dhe raporteve mbi kontributin e diasporës në Kosovë, përjashtim me raportet e Bankës Qendrore në Kosovë. Në përgjithësi ka mungesë të statistikave të cilat pasqyrojnë se ku kryesisht orientohen remitancat. Se sa është i vlefshëm diskutimi mbi aspekte të ndryshme të remitancave në Kosovë janë pyetur edhe pjesëmarrësit e pyetësorit ku 50.50% e tyre vlerësuan se është shumë i vlefshëm, 33.66% i vlefshëm, 11.88% deri diku i vlefshëm, 0.99 pak i vlefshëm, dhe 2.97% vlerësuan se është i pavlefshëm.

Tabela nr.14 Sa është i vlefshëm diskutimi mbi aspekte të ndryshme të Remitancave në Kosovë?



Konkluzionet

Diaspora vazhdon të jetë njëra ndër mbështetjet më të mëdha të Kosovës, e një gjë e tillë më së miri vërehet me shumën e madhe të remitancape të dërguara në vend ndër vite, me theks të veçantë në vitin 2021. Nga raportet e Bankës Qendrore të Kosovës por edhe nga pyetëtori i realizuar nga organizata Germin, u vërejt se diaspora dërgon para në mënyrë aktive në vendin amë duke ndihmuar kështu ekonominë familjare dhe ekonominë e vendit në përgjithësi. Përkundër transferëve të mëdha dhe të shumta që bëhen gjatë vitit, tarifat vazhdojnë të jenë të larta dhe aspak lehtësuese për pjesëtarët e diasporës. Gjithashtu mungon informimi i duhur për përdorim të aplikacioneve ndërkombëtare për transfere me kosto më të lirë.

Ajo çka poashtu është vërejtur dukshëm në pyetësor ka qenë vlerësimi mbi shpenzimin e remitancape dhe dallimin ndërmjet asaj se ku do të duhej të shpenzoheshin. Shpenzimi i remitancape në konsum të produkteve ushqimore dhe kujdesit shëndetësor duhet të vlerësohet si diçka shqetësuese për shtetin e Kosovës, meqë kjo mund të shihet si mos ofrim i mundësive për elementet bazë për jetesë të qytetarëve.

Poashtu, në bazë të hulumtimit është parë nga afër se çdo e treta ekonomi familjare pranojnë remitanca, e shumë familje janë të varura nga remitancat, duke e pasur si burim të vetëm të të ardhurave. Përkundër kontributit të madh të diasporës në forma të ndryshme të remitancape, qofshin ato individuale, kolektive apo donacione, diskutimi për këto kontribute mbetet i zbehtë dhe jo adekuat. Gjatë diskutimeve të cilat ka pasur Germin me përfaqësues të diasporës është bërë e qartë se shteti i Kosovës nuk ka aplikuar ndonjë politikë të duhur që kanalizojnë remitancat drejt zhvillimit të vendit. Duke pas parasysh që remitancat gjithnjë e më shumë janë në rritje, shteti duhet të merr iniciativë të krijoj premisat e para drejtë përdorimit të duhur të remitancape që ndihmojnë zhvillimin e vendit.

Rekomandimet

Rekomandime për pjesëtar të diasporës

Roli i diasporës në vendin amë duhet të shihet përtej remitancave të dërguara. Padyshim që remitancat mbeten një faktor shumë i rëndësishëm për shumë ekonomi familjare, madje edhe për elementet bazë të të jetuarit. Gjithsesi, investimet afatgjata në hapje të bizneseve fitimprurëse do të ndikojnë në punësim dhe rritje të ekonomisë vendore por edhe rritje të të ardhurave vetanake.

Dërgimi i mjeteve monetare natyrisht që duhet të bëhet me informim paraprak nga burime të sigurta dhe nuk duhet të bazohen në të dhëna jovalide në internet apo vetëm bazuar në diskutim me familjarët apo të afërmit. Para se të dërgohen mjetet financiare duhet që dërguesi të marrë informatat e nevojshme nga institucione kredibile.

Marrë parasysh që kosto për dërgim të mjeteve financiare ndryshon nga institucioni financiar në tjetrin si dhe nga faktor të tjerë të ndryshëm (p.sh shpejtësia e arritjes së parave, shuma e parave të dërguara, këmbimi valutor nëse është i aplikueshëm etj), dërguesi duhet të kërkojë për agjencinë e cila i përshtatet më shumë interesit të tij. Në këtë rast edhe përdorimi i aplikacioneve mobile ndërkombëtare për transfer të mjeteve financiare mund të konsiderohet si opsioni më i përshtatshëm.

Rekomandime për personat të cilët pranojnë remitancat

Natyrisht se kur është e nevojshme dhe nuk ka rrugëdalje tjetër, remitancat mund të jenë të hyrat e vetme të cilat shfrytëzohen edhe për gjëra bazike për jetesë siç janë ushqimi apo produktet mjekësore. Por, kjo nuk duhet të ndikoj asnjëherë në joaktivitetin në treg të punës, përveç kur është e pamundur e kundërta.

Investimi i mjeteve të grumbulluara nga remitancat mund të jenë një bazë fillestare për investime fitimprurëse të cilat ndikojnë në stabilitet financiar në ekonominë familjare por edhe përtej saj.

Përfitime të tjera nga anëtarë të diasporës që shkojnë përtej remitancave, për shembull, mund të jetë koncentrimi tek përvoja dhe ekspertiza e tyre në profesione të caktuara.

Rekomandime për institucionet qeveritare dhe financiare

Remitancat që dërgohen brenda një viti janë shumë të mëdha, e në anën tjetër kostot për transfere, në institucione financiare të ndryshme, janë mjaft të larta. Për të lehtësuar barrën e diasporës dhe rritur motivimin drejt kontributit të tyre për vendin e origjinës, duhet të krijohen kushte të përshtatshme në favor të tyre. Koordinimi dhe krijimi i politikave të përbashkëta në mes të institucioneve qeveritare dhe atyre financiare në lidhje me kostot e shërbimit (dërgimit të remitancave nga diaspora) do të motivonte edhe më shumë diasporën të kontribuojnë. Kostot e transferit mund të kategorizohen edhe në bazë të natyrës së remitancave a) Remitancat individuale, kur dërgohen për ekonomi familjare; b) Remitancat kolektive, kur grumbullohen dhe dërgohen nga një komunitet i caktuar në shtetin rezident në vendin e origjinës; c) Filantropia, kur anëtarët e diasporës bëjnë donacione individuale për në vendin e origjinës për një kauzë apo program specifik e cila është në të mirë sociale.

Transferi i mjeteve monetare, sidomos për donacione duhet të kenë një kosto shumë të vogël duke u nisur nga qëllimi i tyre që dërgohen, dhe të gjindet një mekanizëm për lehtësim të transfereve. Gjithsesi, kjo nuk do të thotë që transferet individuale dhe ato kolektive duhet të kenë kosto të transferit të lartë. Andaj institucionet qeveritare në bashkëpunim me bankën qendrore dhe institucionet financiare duhet të krijojnë një treg të qëndrueshëm e të favorshëm për të gjitha palët (dërguesin, pranuesin, dhe institucionin ndërmjetësues).

Rekomandime për Organizata vendore dhe ndërkombëtare

Përkundër pranimet të madh të remitançave në Kosovë ndër vite, shpenzimi i tyre nuk orientohet në investime kapitale të cilat do të gjeneronin të ardhura dhe vende pune, mirëpo një pjesë e konsiderueshme e tyre shpenzohen për gjëra bazike për jetesë, siç janë ushqimi apo produktet mjekësore. Ani pse kjo ndërlidhet me mos stabilitet financiar të ekonomive familjare, faktor i mos shpenzimit adekuat të remitançave është edhe mungesa e edukimit joformal të pranuesve të remitançave. Në Kosovë funksionojnë një numër i madh i organizatave jo qeveritare dhe ndërkombëtare, të cilat me anë të bashkëpunimeve të ndryshme mund të ndikojnë në edukime jo formale.

Disa nga format me të cilat mund të ndikojnë janë organizimi i fushatave këshilluese dhe edukuese për alternativat e investimit adekuat të mjeteve financiare të pranuar nga diaspora, mbajtja e fokus grupeve me qytetarë dhe biznese të vogla e të mesme, trajnime për hapjen e bizneseve të reja, investim në edukim etj. Përveç kontributit të organizatave vendore dhe ndërkombëtare bashkëpunimi dhe partneriteti me institucionet qeveritare do të rriste efikasitetin dhe gjithëpërfshirjen.

Bibliografia

1. Instituti Riinvest, Diaspora dhe politikat e Migracionit, Dhjetor 2007, Prishtinë <https://www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/October/17/shqip1476702625.pdf>
2. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr.36, Tremujori III/2021 https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/02/BQK_VT_TM3-2021.pdf
3. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Vlerësimi Tremujor i Ekonomisë, Nr.36, Tremujori III/2021 https://bqk-kos.org/wp-content/uploads/2022/02/BQK_VT_TM3-2021.pdf
4. Unioni Financiar Prishtinë. Tarifat e Dërgesave nga Kosova. <https://ufp-ks.com/tarifat/>.
5. Banka Botërore. Dërgimi i parave nga Gjermania në Kosovë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en/corridor/Germany/Kosovo>. Qasur më: Janar 2022.
6. Banka Botërore. Dërgimi i parave nga Zvicra në Kosovë. <https://remittanceprices.worldbank.org/en/corridor/Switzerland/Kosovo>. Qasur më: Janar 2022.
7. Agjencia e Statistikave të Kosovës, Anketa e Fuqisë Punëtore, TM1 2021 <https://ask.rks-gov.net/media/6354/afp-tm1-2021.pdf>

